



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 503/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicionit Nisma-AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.503/2019 e datës 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik koalicioni Nisma-AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që një fletëvotim në Vendvotimin 2406A/01R, të shpallet i vlefshëm.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 22.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.503/2019 nga subjekti koalicioni Nisma-AKR-PD, në të cilën pretendohet se më datë 22.11.2019, në ndërrimin e parë (08:00-16:00) në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave, konkretisht në kutinë e votimit 2406A/01R, është shpallur një fletëvotim i pa vlefshëm pa të drejt nga zyrtarët e numërimit në QNR. Shenja apo votimi “X” bazën e ka në hapësirën e Koalicionit Nisma-AKR-PD nr.122 dhe kjo nuk nënkupton se ky fletëvotim është i pa vlefshëm, për arsyen e thjeshtë sepse shihet mirëfilli qëllimi i votuesit ishte të kolicioni Nisma-AKR-PD nr.122 ku edhe e ka vendosur votimin përmes “X” në mënyrë të qartë dhe të rregullt.

Në përgjigjen në ankesë të datës 23.11.2019, të KQZ-së thekson se në vendvotimin 2406A/01R fletëvotimi është shpallur i pavlefshëm për arsye se nuk dihet qëllimi i qartë i votuesit. Shkronja X është shenjë identifikuese e pavlefshmërisë që dmth është i dëmtuar qëllimisht.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provës së bashkangjitur në ankesë dhe hetimit në QNR në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Ankuesi ka paraqitur pretendimin se në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim në kutinë e votimit 2406A/01R të shpallet i vlefshëm sepse bie në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013.

Paneli ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se në kutinë e votimit 2406A/01R, është shpallur një fletëvotim i pavlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit është konstatuar se i njëjti duhet të shpallet i pavlefshëm, ashtu siç edhe kanë vepruar ne QNR me rastin e rinumërimit sepse nuk ka qenë e mundur të vërtetohet qëllimi i votuesit ne rastin konkret.

Nga sa u tha më sipër e në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr. 503/2019 më datën 24.11.2019**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***